

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.07.2023*

14.07.2023

Ora 12:39

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për delegimin e kompetencës Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43, Bashkia Rrogozhinë, për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 korrik 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z.Y.Merkaj, Znj.P. Doçaj, Z.E.Meta**

- **Parti Politike:**

- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, atëherë në rendin e ditës kemi dy çështje: Kemi projektvendimin për delegimin e kompetencës Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor numër 43, Bashkisë Rrogozhinë, për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet e datës 23 Korrik . Projektvendimin që lidhet me plotësimin e vakancës në Bashkinë Gramsh, po vazhdojmë, zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Referuar vendimit nr.28 datë 1 Shkurt 2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin janë përcaktuar procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, në Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor në Komisionin e Qendrës së Votimit dhe në Vendin e Numërimit të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.07.2023*

Votave. Gjithashtu referuar nenit 8 të këtij vendimi është parashikuar edhe vendimi i Komisionerit për delegimin e kompetencës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Referuar këtyre dy dispozitave ligjore kemi përgatitur projektvendimin për delegimin e kompetencave së Komisionit së Qendrës së Votimit dhe Zonës së Administrimit Zgjedhor të Bashkisë Rrogozhinë për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet e datës 23 Korrik 2023. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe për miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, mirë atëherë miratojmë projektvendimin sipas draftit të propozuar. Duke i dhënë autorizimin zonës administrimit në lidhje me kompetencën për akreditim e vëzhguesve, Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor numër 43 Bashkia Rrogozhinë.

Vendimi nr. 703

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.07.2023*

14.07.2023
Ora 12:41

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gramsh, me kandidatin nga lista shumemërore të “Partisë Socialdemokrate”, zj. Erisa Shkelqim Zogu”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z.Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj, E.Meta**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Gramsh, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Servet Xhelal Dedja, propozuar nga subjekti politik “Partia Social Demokrate”. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Social Demokrate, për Këshilli i Bashkisë Gramsh, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 2, zj. Erisa Shkelqim Zogu. E cila ka plotësuar dhe dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 13729. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Erisa Shkelqim Zogu, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Nga

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.07.2023*

informacioni i marrë nga zyra e gjëndjes civile dhe zyra e gjëndjes gjyqësore rezulton se kandidatja për anëtarë të këshillit të bashkisë Gramsh nuk ka ndryshuar përbërësit e gjëndjes civile si dhe nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Erisa Shkelqim Zogu, në Këshilli i Bashkisë Gramsh, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim.

Z. I. Celibashi:Atëherë, plotësojmë vakancën në Këshillin e Bashkisë Gramsh me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Social Demokrate me zonjën Erisa Shkëlqim Zogu. Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr.704

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

